




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR SEMAN

VENDIM

Nr.5, datë 06.03.2023

PËR



**MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR  
SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM HIDROENERGJETIK  
SHOQËRISË “MP-HEC” SH.P.K**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujqor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujqor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujqor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujqore, Këshilli i Basenit Ujqor Seman.

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e lejes për përdorim burimi ujqor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik shoqërisë “Mp-Hec”, sipas Kontratës së Koncesionit të formës “BOT” Nr. 311 Rep., Nr. 918/2 Kol., të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (Autoriteti Kontraktues) dhe Bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Devy” sh.p.k. dhe “Zyfi” sh.p.k (Koncesionari) datë 02.02.2009, e ndryshuar për ndërtimin e hidrocentralit “Niçë” Shkresën e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 11965 Prot., datë 13.12.2018 “Miratohet projekt i zbatimi i përmirësuar i hidrocentralit Niçë” Raportin e Oponencës Teknike të AKBN-së Nr. 5032/1 Prot., datë 10.06.2015 mbi projektin e zbatimit të përmirësuar të HEC-it “Niçë”, të shoqërisë koncesionare “MP-Hec” sh.p.k Kontratën shtesë të koncesionit Nr. 1780 Rep., Nr. 556 Kol., datë 20. 06.2022 për ndërtimin e hidrocentralit Niçë e ndryshuar me vendndodhje lumi Velçan Qarku Korçë.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

## HEC Niçë

### Vendndodhja e veprës së marrjes-1/ burimi ujq Përroi Niçë

- X= 548959.26; Y= 4518243.75; Z=909 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse: 1.96 m<sup>3</sup>/s
- Prurja mesatare vjetore: 0.98 m<sup>3</sup>/s
- Prurja mesatare e muajit më të thatë: 0.803 m<sup>3</sup>/s
- Prurja ekologjike: 0.044 m<sup>3</sup>/s

### Vendndodhja e veprës së marrjes-2/ burimi ujq Përroi i Mesmalit

- X= 548271.86; Y= 4516910.95; Z=912 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse: 1.54 m<sup>3</sup>/s
- Prurja mesatare vjetore: 0.803 m<sup>3</sup>/s
- Prurja mesatare e muajit më të thatë: 0.653 m<sup>3</sup>/s
- Prurja ekologjike: 0.036 m<sup>3</sup>/s

### Vendndodhja e godinës së Centralit

- X= 548040.49; Y= 4514956.54; Z=824 m.m.n.d. (KRGJSII)
- Prurja që shkarkohet: 3.5 m<sup>3</sup>/s
- Prodhimi vjetor i parashikuar: 9.799.224 kwh/vit
- Fuqia e instaluar: 2.270 kwh
- Vlera totale e investimit: 300.133.140 lekë

3. Zbatimi i kontratës nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

**KRYETARI I KBU SEMAN.**

**LEFTER SHEHAJ**

